



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE  
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**VENDIM**

**Nr.41, datë 23. 10 .2024**

**PËR  
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR NDRYSHIMIN E  
NIVELIT TARIFOR TË SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME  
ELBASAN SH.A**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**ligji nr. 8102**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021 "Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime" (**vendimi i KKRR nr. 539**),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 23.10.2024 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a. për miratimin e ndryshimit të nivelit tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura,

**Konstatoi se:**

1. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) me vendimin nr. 16 datë 28.04.2023, "Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a." ka licencuar shoqërinë Rajonale UK Elbasan për ushtrimin e veprimtarisë së grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura për një afat 4 vjeçar.
2. Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a. me shkresën nr. 1496 prot. datë 28.06.2024, me lëndë "Kërkesë për ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura" ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për rishikimin e nivelit tarifor për shërbimet ujësjellës kanalizime.
3. Në zbatim të pikës 1 të nenit 10 të Metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime, shoqëria rajonale UK Elbasan sh.a në aplikimin për ndryshim të nivelit tarifor duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesa zyrtare drejtuar ERRU për ndryshimin e tarifave për shërbimet ujësjellës, kanalizime dhe ITUN;
  - b) Pasqyrat Financiare të vitit paraardhës certifikuar nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar;
  - c) Modeli i aplikimit për nivelin e ri tarifor. Të gjitha tabelat e modelit paraqiten të printuara dhe të firmosura nga shoqëria dhe sipas formatit Excel të miratuar nga ERRU;
  - d) Organigramë dhe përshkrimet e punës së stafit sipas pozicionit të tyre;
  - e) Aktmarrëveshjet e kredisë midis shoqërisë dhe institucioneve kredi dhënëse, në rast se shoqëria është financuar me Hua dhe skema e planit mujor të shlyerjeve gjatë viteve të kaluara dhe viteve të ardhshme;
  - f) Mendimin e Pushtetit Vendor për tarifën e propozuar të shprehura në vendimin përkatës dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut për legjitimitetin e tij;
  - g) Vendimi i Këshillit të Administrimit për miratimin e tarifave të propozuara;
  - h) Proces Verballi i Seancave Dëgjimore me Publikun sipas formatit të përcaktuar nga ERRU;
  - i) Subvencionet e përfituara nga operatori dhe ato të nevojshme gjatë periudhës rregulatore të tarifave të propozuara;
  - j) Lejet ose Autorizimet për përdorimin e ujit për shoqëritë UK lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor të shoqëruara me Marrëveshjen ndërmjet shoqërisë UK dhe KBU për pagesën e tarifave për përdorimin e ujit;
  - k) Raport i detajuar për gjendjen teknike të sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura, në të cilën të përshkruhet inventari i aseteve në përdorim të shoqërisë me të dhëna teknike (përmasat, lloji i materialit, vitit të instalimit/ndërtimit), përfshirë dhe prioritetet për zëvendësimin e tyre. Ky material do të hartohet sipas formatit të përcaktuar nga ERRU;
  - l) Relacion analitik ekonomik për vitin paraardhës, si dhe për periudhën rregulatore që kërkohet ndryshimi i tarifave, në të cilën shprehet qartë justifikimi dhe argumentet përkatëse dhe objektivat e shoqërisë për përmirësimin e treguesve të punës;
  - m) Në rast se shoqëria aplikon për tarifë shitje uji me shumicë, në kërkesën e saj për tarifa duhet të paraqesë: relacion teknik dhe ekonomik me llogaritjet e tarifës së shitjes së ujit me shumicë, miratimin e tarifës së kërkuar nga organet drejtuese si dhe akt marrëveshjet midis palëve shitës-blerës;
  - n) Të ketë shlyer detyrimet për pagesën rregulatore sipas kontratës së nënshkruar midis ERRU dhe shoqërisë dhe në rast të detyrimeve të prapambetura të ketë shlyer sipas marrëveshjes së nënshkruar mes tyre për shlyerjen me këste të tyre;
  - o) Deklarata për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave sipas nenit 26 dhe nenit 46 të kësaj metodologjie.
4. Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria rajonale UK Elbasan sh.a është plotësuar sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 10 të Metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë Rajonale UK Elbasan është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në Vendimin e KKRR nr. 539 datë 30.12.2021 dhe kuadrin rregullator në fuqi:

## **VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a. për miratimin e ndryshimit të nivelit tarifor për shërbimet ujësjetllës kanalizime.
2. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike për njoftimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYETARE**

**Evis SHURDHA**

Konceptoi: S. Kraja  
F. Beqiri  
Konf: F. Imeraj  
Nr. i kopjeve: 2 (dy)  
Data:23.10.2024